



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 16**

Datë: 19. 05. 2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

## **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
  - 2. Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së në Zgjedhjet Parlamentare të datës 11 qershor 2017**
  - 3. Të ndryshme**
- 

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Së pari e hapim mbledhjen e 16 -të të vitit 2017 të KQZ-së. A ka dikush ndonjë pikë të rendit të ditës për me shtuar, apo për me hjekë? Nëse jo, unë i kam edhe dy njoftime të ndryshme. Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

## **2. Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së në Zgjedhjet Parlamentare të datës 11 qershor 2017**

**Valdete Daka:** azhdojmë me pikën e parë: Diskutim lidhur me rolin e OSBE-së në zgjedhjet parlamentare të datës 11 qershor. Ju e dini, që ne tash e kemi një praktikë, nga viti 2013-2014, ku misioni i OSBE-së ka pasë një rol të kufizuar duke u bazuar në kompetencat, të cilat na jep ligji, që ne mundemi me partnerët e jashtëm me lidhë marrëveshje, lidhur me asistencën eventuale, teknike. Edhe këtë radhë konsideroj që, duke marrë parasysh edhe rrethanat politike dhe situatën, ende, e cila është deri diku e brishtë në katër komuna specifike të Kosovës. Konsideroj që misioni i OSBE-së do të mund t'a angazhojmë përsëri, por jo në rolin të cilin e ka pasë në vitin 2013-2014. Reduktohet roli edhe me tutje. Shpresoj që në zgjedhjet e ardhëshme të reduktohet plotësisht dhe mos të ketë nevojë fare për kurrëfar ndihme, as teknike. Unë kisha propozuar që misioni i OSBE-së të minimizohet aq sa është e mundur, betëm në këshilla teknike për komisionet komunale të zgjedhjeve dhe ndihmë teknike për këshillat e vendotimeve në ditën e zgjedhjeve. Pra, pa ndonjë rol tjetër, eventual, në procesin zgjedhorë të 11 qershor.

A ka dikush me thënë diçka? Po, urdhëro!

**Betim Gjoshi:** Unë, siç e dini qëndrimin tim, e kam mbajtur në vazhdimësi. Unë, kam qënë i interesuar që, filimisht IFES-i me ardhë. Kjo, për shumë arsye. E para, nuk është që ne etnikisht kemi ndonjë prapavijë në qëndrimet tona, por ka të bëjë se kanë qënë 4 komunat ku kemi pasë probleme në zgjedhjet e fundit. Ne, kemi pasë në 2010, po e zëmë, në një pjesë tjetër të territorit të Kosovës probleme, por në zgjedhjet e fundit kemi pasë në këtë pjesë probleme. Për me e ruajt votën, me ruajt integritetin e zgjedhjeve. Me ndalu manipulimin me votë dhe keqperdorim me atë, mendoj ka qënë e nevojshme që ne të kemi prezencë më të shtuar në këto qendra të votimit. Mundësisht çdo vendvotim. Intenca jonë është çdo vendvotim. Sa i përket terminologjisë, ne në qoftë se kemi ndonjë terminologji më të mirë, shkresa në pergjithësi të mirë, në perjashtim, ndoshta, e diskutuam edhe me Shrefin çështjen e kësaj. Shembull ndihmë teknike, po e zëmë. Apo vetëm ndihmë po e lëjmë. Cila është terminologjia më e mirë...?

Për mua, tha z. Gjoshi, është e pranueshme kështu siç është. Nuk kam ndonjë problem, ta kemë të qartë si anëtar i KQZ-sëmë ndihmon shumë edhe ajo pjesa ku ne kemi thënë që, të ofrohet një transparencë e madhe. Të jetë në pajtim me rregullativen dhe ne pajtim me vendimet e KQZ-së mbarëvajtja e procesit zgjedhorë. Edhe unë deshiroj që, zgjedhje, pa zgjedhje të vijmë deri te situata ku krejt që zgjedhjet në territorine Kosovës të mbahen nga trupa zgjedhorë ashtu siç e parasheh ligji zgjedhorë. E, qysh do të mbahen edhe tani, por pa ndihmen dhe lehtësimin e askujt. Përveç kësaj, unë mendoj që ne kemi një takim nesër me BE. Është mirë që me kerku që ata prezencën më të madhe të vezhimit me pasë në këto qendra. Kjo është ajo çka deshta me thënë. E për krahi.

**Adnan Rrustemi:** Po..., në rradhë të parë, parimisht unë e mboroj qëndrimin që KQZ-ja është institucioni i vetëm që do të organizoj zgjedhjet kudo. Ne, kemi themeluar tashmë Komisionet Komunale Zgjedhore për secilin komunë edhe për komunat në pjesën veriore. Natyrisht që mirë që është reduktu dmth roli që ka pas. Ndoshta mundët me u plotësu kjo shkres, unë jam për me u siguru kjo shkres, unë jam për me u siguru transparencë dhe integriteti i zgjedhjeve, megjithatë insistoj me kon gjithqka mrena

infrastruktues kushtetuse të vendit. Unë parimisht , unë do të abstenoj ç'është e vërteta, megjithatë..., po propozoj që kjo fjala “ndihmë” mu zëvendëso me fjalën “mbështetje” sepse, a është ndonjë lloj mbështetje që nuk, edhe lehtësim bënë, edhe këtu ku është në legjislacionin në fuqi, kisha thanë me konkritizuar në pajtim me ligjet dhe me kushtetutën.

**Valdete Daka**: Kush është për, apo kush është kundër ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan mbështetjen teknike ( me 6 vota për, dhe 1 votë abstenim – Adnan Rrustemi) të OSBE-së lidhur me zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend 2017

**Valdete Daka**: Tani, kam dy njoftime të shkurtëra: Sot në ora 12:00, siç e dini, nëshkruhet marrëveshja me BE-në dhe me Ministrin e Punëve të Jashtme të cilët, do të jenë këtu prezentë kush kish qenë i interesuar kish qenë mirë me qenë prezentë. Ndërsa, në ora 15:00, është vizita e Ambasadorit Amerikan, dhe ju kisha kërkuar që të jeni prezentë në këtë takim.

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----